REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/ Municipality of Kaçanik
Drejtoria për Buxhet dhe Financa

KAÇANIKU

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

	Data 13.07.26	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
05	400/01-17355/26	

NJOFTIM PUBLIK

Për organizimin e dëgjimeve buxhetore lidhur me përgatitjen e projektbuxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2027 dhe vlerësimeve buxhetore 2028–2029

Komuna e Kaçanikut, përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, njofton qytetarët, institucionet, organizatat joqeveritare, shoqëritë kulturore-artistike, artistët, të rinjtë, klubet sportive, përfaqësuesit e bizneseve, fermerët, përfaqësuesit e sektorit të shëndetësisë dhe të gjitha palët e interesuara se do të organizohen dëgjime buxhetore në kuadër të procesit të hartimit të projektbuxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2027 dhe vlerësimeve buxhetore për vitet 2028–2029.

Ky proces zhvillohet duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Kaçanikut, Qarkoren Buxhetore 2027/01, si dhe nenin 31 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

Projektbuxheti dhe materialet shpjeguese do të jenë të hapura për konsultim publik nga data 13.07.2026 deri më 31.07.2026, ndërsa dëgjimet buxhetore do të mbahen sipas orarit në vijim:

ORARI I DËGJIMEVE BUXHETORE

Nr.	Dëgjimi buxhetor	Data	Ora	Vendi
1.	Me organizatat joqeveritare, shoqëritë kulturore-artistike, artistët, të rinjtë, klubet sportive dhe përfaqësuesit e bizneseve	27.07.2026 (e hënë)	14:00	Salla e Kuvendit të Komunës
2.	Me përfaqësuesit e sektorit të shëndetësisë	28.07.2026 (e martë)	11:00	QKMF – Kaçanik
3.	Me fermerët e Komunës së Kaçanikut	28.07.2026 (e martë)	14:00	Salla e Kuvendit të Komunës
4.	Dëgjim i përgjithshëm buxhetor me qytetarët e Komunës së Kaçanikut	29.07.2026 (e mërkurë)	14:00	Salla e Kuvendit të Komunës

Komentet, vërejtjet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri më 31.07.2026, në ora 16:00, tek Udhëheqësja e Sektorit për Buxhet dhe Financa, znj. Fitore Vishi, në në emailin: fitore.vishi@rks-gov.net

Dokumenti i projektbuxhetit dhe materialet përkatëse do të publikohen edhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut, në rubrikën "Buxheti dhe Financat":

https://kacanik.rks-gov.net/buxheti-financat/

Komuna e Kaçanikut fton qytetarët dhe të gjitha palët e interesuara që të marrin pjesë në dëgjimet buxhetore dhe të kontribuojnë me propozime, komente dhe sugjerime për një planifikim buxhetor sa më transparent, përmbajtësor dhe gjithëpërfshirës.

Mirëpresim pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj!